



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listave shumemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet për qeverisjen vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 566 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

VËREN

Partia Bindja Demokratike, në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillin e bashkisë Mallakastër si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezultoi se asnjë prej kandidatëve nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në përgjigje të shkresës, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në KQZ, verifikim i gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak Mallakastër sipas të cilës rezultoi:

FATMIR VEIZAJ kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia Bindja Demokratike me numër rendor 01, Bashkia Mallakastër. Sipas shkresës nr.3448 prot, dt.17.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1577/1, datë 17.05.2019, rezultoi me vendimin nr.382, datë 28.05.2015 Gjykata e Rrethit Fier e deklaroi fajtor për veprën penale "Shpërdorim detyre në bashkëpunim" parashikuar nga neni 248-25 i K.Penal dhe në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim. Me vendimin nr.185, datë 30.03.2016 Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

ENVER RESULAJ kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia Bindja Demokratike me numër rendor 03, Bashkia Mallakastër. Sipas shkresës nr.3448 prot, dt.17.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1577/1, datë 17.05.2019, rezultoi me vendimin nr.458, datë 17.12.2009 Gjykata e Rrethit Vlorë e deklaroi fajtor për veprën penale "Fallsifikim të akteve të gjendjes civile" parashikuar nga neni 191/3 i K.Penal e dënonte me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë. Në bazë të nenit 59 të K.penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për një afat kohe prej 5 vitesh.

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.143, datë 01.04.2013 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.458, datë 17.12.2009 me ndryshimin: Prishjen e këtij vendimi për pjesën që është



Nr . 566 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

vendosur dënimi me gjobë dhe pushimin e çështjes për këtë pjesë. Z. Enver Resulaj për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar germës b, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave për b) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në Kreun X "Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve", të Kodit Penal;

Ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja "b", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga **z. Fatmir Veizaj kandidat me numër rendor 01, për anëtar këshilli i Bashkisë Mallakastër**, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal, datës së vendimit nr. 382, datë 28.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, masës së dënimit **z. Fatmir Veizaj** për kryerjen e kësaj vepre penale është brenda periudhës së ndalimit për zgjedhjen në funksionin, kandidat për këshilltar i këshillit të bashkisë Mallakastër.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturave, referuar nenit 10 pika 1, germa "a" të ligjit 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z. **Fatmir Veizaj** dhe t'i kërkoj subjektit zgjedhor Parta Bindja Demokratike të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 10, pika 1, germa "a" e Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" shpall faktin se z. Fatmir Veizaj është në kushtet e moszgjedhshmërisë si kandidat për anëtar Këshilli të Bashkisë Mallakastër.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për personat e tjerë të shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë Mallakastër sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.



Nr . 566 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Në këtë rast, KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Mallakastër të Partisë Bindja Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Fatmir Veizaj për këshillin e bashkisë Mallakastër, Partia Bindja Demokratike.
2. Njoftimin e Partisë Bindja Demokratike të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Njoftimin e KZAZ-së nr.61, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Mallakastër, Partia Bindja Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 566 i vendimit Data 19.05.2019 e vendimit Ora 18:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve të listës shumëmemërore për Këshillat Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.